

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2022

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundi mit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	10.01.2022	Kompania 'X' është pa administrator kërkojmë nga institucioni juaj si është vepruar deri tani? Nëse nuk janë bërë pagesat a keni marrë masa gjatë vitit 2018 e deri në fund të vitit 2021 që kompania u bllokua? Cilat janë masat e marra?	12.01.2022	Identifikimi i tatimpaguesve në Administratën Tatimore bëhet nëpërmjet NIPT-it (numri i identifikimit të personit të tatueshëm), i cili është unik dhe i papërsëritshëm. Ju lutem për të marrë informacionin e kërkuar identifikoni subjektin nëpërmjet NIPT-it.	E plotë	Nuk ka
2	11.01.2022	A është në dijeni institucioni juaj për nismën e Ministrisë së Mjedisit për ndalimin e prodhimit/qarkullimit/tregti mit/ përdorimit të qeseve plastike në vendin tonë? A do të mbyllen biznese/kompani të cilat kanë lidhje me prodhimin e këtij produkti në vendin tonë? Sa biznese operojnë aktualisht në vendin tonë?	21.01.2022	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është në dijeni për nismën që Ministria e Mjedisit ka marrë për ndalimin e prodhimit, shitja dhe futja e qeseve plastike për përdorim individual. Nuk jemi në dijeni për ecurinë e aktiviteteve të këtij sektori pasi është vendimmarrje e tyre, por mendojmë se i është dhënë koha e mjaftueshme për të përshtatur aktivitetin e tyre. Nëse këto biznese do të mbyllen, pra nuk do të përshtaten në prodhime të formave të tjera të plastikës, do të ketë efekt edhe në uljen e	E plotë	Nuk ka

		Sa është numri i të punësuarve në këto biznese?		numrit të të punësuarve, por mendojmë që nisma është shumë e dobishme për të siguruar një ambient të pastër me shumë përfitime për popullatën dhe ekonominë në përgjithësi. Në lidhje me pyetjen 4 dhe 5, Organet Tatimore administrojnë të dhëna në lidhje me tatimpaguesit vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike dhe nuk administron të dhëna sipas përcaktimit të cituar nga ju.		
3	12.01.2022	Informacion mbi rentën minerare nga viti 2015-2021, rreth 6 subjekteve gurore.	24.01.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës në lidhje të dhënat e pagesave të rentës minerare në total nga viti 2015-2021, për 6 subjekte gurore.	E plotë	Nuk ka
4	13.01.2022	Sa është numri total i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve deri më 31 dhjetor 2021, i ndarë sipas statusit (aktiv, pasiv, çregjistruar) dhe formës ligjore? Sa është numri total i OJF të regjistruara gjatë vitit kalendarik 2021? Sa është numri total i OJF të regjistruara në skemën e TVSH-së? Sa është numri i OJF të regjistruara në skemën e	26.01.2022	Numri total i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve deri më 31 dhjetor 2021 është 5174. Aktiv-2217, Çregjistruar-178, Kërkesë për çregjistrim-49, Pasiv-2730. Numri total i organizatave jofitimprurëse të regjistruara gjatë vitit kalendarik 2021 është 230. Numri total i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në skemën e TVSH është 946. Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në skemën e TVSH gjatë vitit kalendarik 2021 është 27. Numri total i organizatave jofitimprurëse të çregjistruara nga skema e TVSH është 643.	E plotë	Nuk ka

		<p>TVSH gjatë vitit kalendarik 2021?</p> <p>Sa është numri total i OJF të çregjistruara nga skema e TVSH-së?</p> <p>Sa është numri i OJF që janë regjistruar për rimbursimin e TVSH për fondet e përfituara nga donatorët e huaj?</p> <p>Sa është numri i OJF të cilat kanë qenë subjekt i sanksioneve, cilat kanë qenë arsyet për marrjen e tyre?</p>		<p>Numri total i organizatave jofitimprurëse që janë regjistruar për rimbursimin e TVSH për fondet e përfituara nga donatorët e huaj është 34.</p> <p>Numri i organizatave jofitimprurëse të cilat kanë qenë subjekt i sanksioneve tatimore është 4537.</p> <p>Arsyet për marrjen e sanksioneve, ka qenë mosrespektimi nga ana e tyre i legjislacionit konform të gjitha ligjeve tatimore.</p> <p>Numri i të punësuarve, i deklaruar nga organizatat jofitimprurëse tek AT është 9804.</p>		
5	19.01.2022	<p>Shtetësja Italiane F.G. kërkon të informohet mbi përjashtimin nga taksimi i dyfishtë.</p>	28.01.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës për t'u pajisur me Çertifikatë Rezidence Tatimore nga DPT, sipas Marrëveshjes Tatimore të përfunduar ndërmjet RSH dhe Italisë, për efekt të përfitimit të pensionit nga shteti Italian, iu sqarojmë procedurën që duhet ndjekur për të aplikuar në DPT:</p> <p>Kërkesë me shkrim në të cilën të përcaktohet shteti dhe viti fiskal për të cilën aplikojnë, si dhe informacion të plotë në lidhje me arsyet e kërkesës për pajisje me Çertifikatë Rezidence Tatimore.</p> <p>Vërtetim origjinal lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit në të cilin jepen hyrjedaljet në Republikën e Shqipërisë, si dhe vërtetim në lidhje me adresën e banimit, si dhe kopje të dokumentit/dokumentave identifikues të përdorur nga individi aplikues.</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat personale të përfituara dhe deklaruar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Kontrata e pronësisë së bashku me një kopje të çertifikatës së pasurisë së paluajtshme, të banesës ku banon apo kontrata e qerasë sipas rastit, ku referuar kësaj të fundit dhe pagesën e tatimit mbi qeranë të mbajtur në burim.</p> <p>Kopje të dokumentit të identifikimit, passaportë ose kartë identiteti, brenda afateve ligjore përpara i takon vlefshmërisë.</p>		
6	25.01.2022	<p>A është kryer regullimi i deklarimit të pagave nga bizneset?</p> <p>Sa është numri i bizneseve të cilat kanë regulluar pagat e deklaruar? Sa prej tyre nuk e kanë kryer ende këtë proces?</p> <p>Çfarë masash do të merren për këto biznese?</p> <p>Sa është numri i bizneseve të cilave iu është drejtuar letër për vetëregullim të pagave të deklaruar përpara datës 20.01.2022?</p>	07.02.2022	<p>Informacionin e plotë në lidhje me kërkesën tuaj e gjeni në linkun e mëposhtëm:</p> <p>https://www.financa.gov.al/njesia-speciale-antiinformalitet-reagim-pozitiv-i-tatimpaguesve-per-rritjen-e-pagave/</p>	E plotë	Nuk ka
7	25.01.2022	<p>Si lejohet një shtetas i huaj pa dokumenta të regullta në vendin tonë të ketë biznes?</p> <p>Si mbrohen punëtorët kur jemi në këtë situatë?</p>	05.02.2022	<p>Procedurat e regjistrimit, ndryshimit të të dhënave të regjistrimit, çregjistrimit etj, kryhen sipas Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, 'Për Regjistrimin e Biznesit', i ndryshuar. Për më shumë informacion lidhur me këto</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>procedura, duhet të drejtoheni pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.</p> <p>Marrëdhënia punëdhënës - punëmarrës, është një marrëdhënie ligjore detyrimi e cila bazohet në një kontratë të lidhur midis palëve. Pretendimet kontraktore sipas përcaktimeve ligjore ndiqen gjyqësisht.</p>		
8	25.01.2022	<p>Kompania 'X' është pa administrator kërkojmë nga institucioni juaj si është vepruar deri tani?</p> <p>Nëse nuk janë bërë pagesat a keni marrë masa gjatë vitit 2018 e deri në fund të vitit 2021 që kompania u bllokua?</p> <p>Cilat janë masat e marra?</p>	05.02.2022	<p>Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.</p>	E plotë	Nuk ka
9	26.01.2022	<p>Jemi biznes i vogël inputesh bujqësore pa TVSH. Me hyrjen në fuqi të TVSH prej 10% të imputeve bujqësore a duhet t'a pasqyrojmë në kuponin e shitjes këtë ndryshim.</p>	27.01.2022	<p>Referuar për sa kërkonti citojmë: "Jemi biznes i vogël inputesh bujqësore pa TVSH. Me hyrjen në fuqi të TVSH prej 10% të imputeve bujqësore a duhet t'a pasqyrojmë në kuponin e shitjes këtë ndryshim" ju bëjmë me dije se, nisur nga fakti që tatimpaguesi deklaroi që jam biznes i vogël pa tvsh, në faturën e lëshuar nga ana e tatimpaguesit nuk duhet shënuar shkalla tatimore e reduktuar prej 10%.</p> <p>Nëse tatimpaguesi ka qenë më parë i regjistruar me përgjegjësinë tatimore të TVSH, atëherë nga Janari 2022 aplikon shkallën e reduktuar prej 10%.</p>	E plotë	Nuk ka

10	27.01.2022	Informacion si të plotësojë Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave për vitin 2020.	27.01.2022	Individët të cilët kanë detyrimin për të dorëzuar Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), duhet të hyjnë në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në menunë e - Shërbime, nënmenu e -Shërbime - Për Individët , ku shpjegohet mënyra që duhet të ndiqet për plotësimin e DIVA-s.	E plotë	Nuk ka
11	03.02.2022	Sa Call Centera janë tatimpagues në institucionin tuaj? Sa punonjës janë në total? Si dhe për çfarë ushtrohen kontrollet në këto kompani gjatë vitit sipas kompetencës që ka institucioni juaj? A e bashkërendoni punën me institucione të tjera? Nëse po me cilët dhe si?	15.02.2022	Tatimpagues Call Center aktiv janë 599. Numri i të punësuarve në total për periudhën e fundit tatimore, Dhjetor 2021 është 13,355. Kontrollet në të gjithë tatimpaguesit përfshirë edhe call center nga administrata tatimore realizohen bazuar në Modulin e Riskut që është një modul informatik i cili përzgjedh tatimpagues mospërmbyshës bazuar në kritere risku të përcaktuara më parë. Ata tatimpagues që kanë numrin më të madh të kritereve të riskut të thyera i ushtrohen kontrollit tatimor. Bashkëpunimi me institucione të tjera mund të ndodhë në rastet kur kjo kërkohet në formë shkresore ose bazuar në një plan pune të dakordësuar paraprakisht. Administrata Tatimore ka marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj. Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, fokusi është rritja e bashkëpunimit me institucionet ndërvepruese në gjurmimin e	E plotë	Nuk ka

				veprave penale në fushën e tatimeve, shkëmbimi i informacioneve në kohë reale dhe ngritja e grupeve të përbashkëta të kontrollit.		
12	04.02.2022	<p>Sa është numri i subjekteve tatimore (pajisur me NUIS) që operojnë në fushën e Ndërmjetësimit të Pasurive të Paluajtshme? Si është i shpërndarë në qytete/qarqe ky numër?</p> <p>Sa është numri i të punësuarve në subjektet si më sipër, që Operojnë në fushën e Ndërmjetësimit të Pasurive të Paluajtshme? Si është i shpërndarë në qytete/qarqe ky numër?</p> <p>Sa kanë qenë të ardhurat në Tatimet nga transaksionet me pasuritë e paluajtshme, për secilin vit, nga 2011-2021 (11 vite), të ndara sipas qyteteve në vend?</p>	09.02.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
13	11.02.2022	<p>Sa janë detyrimet tatimore të papaguara (borxhi), që kanë drejtuesit e automjeteve në Republikën e Shqipërisë?</p> <p>Si është parashikuar mbledhja e debisë së këtyre shtetasve që kanë në</p>	14.02.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12 ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja	E deleguar	Nuk ka

		përdorim automjetin, me taksat e papaguara? Sa është numri i automjeteve në qarkullim që janë debitorë?		e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”		
14	21.02.2022	Raportin e rasteve të denoncuar dhe të regjistruara për shkelje të ligjit, lidhur me fshehjen e xhiros ditore reale nga bizneset për vitet 2020-2021. Cilat janë zonat që janë më të predispozura për evazionin fiskal? Sa biznese janë penalizuar gjatë vitit 2020-2021? A kontrollohen bizneset e vogla në lagjet e thella të Tiranës?	03.03.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
15	22.02.2022	Sa ka qenë numri i testeve SARS – COV2 me PCR të deklaruar të kryera nga laboratorët jopublikë gjatë vitit 2020-2021? Sa ka qenë numri i testeve serologjike të deklaruar të kryera nga laboratorët jopublikë gjatë vitit 2020 - 2021?	22.02.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12 ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarësin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”	E deleguar	Nuk ka

		<p>Sa ka qenë numri i testeve të shpejta me antigjen të deklaruar të kryera nga laboratorët jopublikë gjatë vitit 2020-2021?</p> <p>Nëse jo nominalisht për laboratorët sa ka qenë numri në total i testeve covid të kryera gjatë vitit 2020-2021?</p>				
16	23.02.2022	<p>Në cilat subjekte ka qenë i punësuar brenda 5 (pesë) viteve të fundit?</p> <p>Sa ka qenë paga mujore bruto e deklaruar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit?</p> <p>Deri në cilën datë rezultoi i punësuar?</p>	23.02.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
17	23.02.2022	<p>Sa është numri i referimeve/kallëzimeve penale të kryera nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për periudhën Nëntor-Dhjetor 2021.</p> <p>Informacioni të jetë i ndarë sipas Strukturave Hetimore të Drejtorive Rajonale dhe të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.</p>	25.02.2022	<p>Lidhur me referimet në Prokurori nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për periudhën Nëntor-Dhjetor 2021, janë referuar 14. Referimet për veprat penale parashikohen në nenin 131 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 'Për Procedurat Tatimore në RSH', i ndryshuar, dhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Përsa i përket ndarjes sipas rajoneve iu bëjmë me dije se referuar strukturës së re të Administratës Tatimore, Drejtoria e Hetimit Tatimor është e organizuar në nivel Qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.</p>	E plotë	Nuk ka

18	02.03.2022	Informacion për rastin e shtetasve amerikan që përfitojnë një pension në SHBA, janë të përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat e pensionit.	09.03.2022	<p>Në nenin 8/1 “të ardhurat e përjashtuara“, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet se;</p> <p><u>Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale:</u></p> <p>1/1. Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare <i>apo</i> të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.</p> <p>Gjithashtu, në nenin 8/2 të ligjit, pika 1, përcaktohet se:</p> <p><u>1.Për të përfituar nga përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat, personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> a) të jenë përfitues të pensionit sipas legjislacionit në fuqi në vendet ku e kanë përfituar atë b) të jenë pajisur me leje qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë c) të mos kenë qenë ndonjëherë të dënuar në shtetin e vet apo në Republikën e Shqipërisë ose në 	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

				<p>ndonjë shtet tjetër për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie</p> <p>d) të kenë marrë përgjigje pozitive nga struktura përgjegjëse administrative për përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat personale të përfitimit të pensionit. Kërkesa e palëve të interesuara duhet të shoqërohet me dokumentet provuese për parashikimet e shkronjave “a”, “b” e “c”, të kësaj pike, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm</p> <p>3. Personat përfitues sipas pikës 1/1, të nenit 8/1, të këtij ligji, <u>humbasin të drejtën e përjashtimit nga tatimi mbi të ardhurat në kushtet e mosripërtëritjes së lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë</u>, kur për këtë nuk është bërë kërkesë në strukturat përgjegjëse deri 6 (gjashtë) muaj nga data e mbarimit të lejes. Në rast përgjigjeje negative ose të mungesës së përgjigjes nga struktura përgjegjëse administrative, brenda afateve ligjore të parashikuara, palës së interesuar i lind e drejta për ankimim administrativ, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.</p> <p>Në përfundim, referuar dispozitave të mësipërme, sqarojmë se;</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p><i>Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e ngjashme të shtetasve të huaj, përfshi këtu edhe me origjinë shqiptare, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare, që janë rezidentë në RSH, janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.</i></p> <p>Po në referim të dispozitave tatimore të nenit/1 dhe nenit 8/2, këta individë nëse janë të interesuar që të jenë përfitues nga zbatimi i këtij ligji dhe/ose dispozitë duhet të kenë leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe në kërkesën e drejtuar DPT, duhet që të bashkëlidhin dokumenta provuese për parashikimet sipas gërmave të pikës 1 të nenit 8/2, sa me sipër, si dhe një kopje të pasaportës së tyre të lëshuar nga shteti ku kanë vendbanimin e përhershëm, pa përjashtuar këtu edhe kërkesat e publikuara nga DPT në faqen zyrtare në lidhje me aplikimin për certifikatë rezidence në Shqipëri.</p> <p>Pra, referuar kërkesës të ardhur nga ADISA, pensionet e huaja nuk janë të tatueshme në Shqipëri, me kushtin që individit të ketë plotësuar kushtet e të qenit rezidentë, të jetë i pajisur me leje qëndrimi, si dhe të ketë të plotësuar kërkesat e gërmave të pikës 1 dhe 2 të nenit 8/2 të Ligjit 8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, ku këto të fundit provohen me dokumentacion nga ana e individit, që shoqërojnë kërkesën e tyre për të përfituar nga përjashtimi i tatimit.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

19	03.03.2022	<p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 dhjetor 2021.</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse me status aktiv të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2021.</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 dhjetor 2021 i ndarë sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër)</p> <p>Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2021.</p> <p>Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2021 të ndara sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër).</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të shpërbëra dhe në proces</p>	09.03.2022	<p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 Dhjetor 2021 është 5174.</p> <p>Numri i përgjithshëm i oganizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore gjatë vitin 2021, por sot janë me statusin aktiv është 214.</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore deri në 31 dhjetor 2021 i ndarë sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër) – nuk ekzistojnë forma ligjore të tilla.</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore gjatë vitit 2021 është 230.</p> <p>Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në administratën tatimore për vitin 2021 (nga 1 janar deri në 31 dhjetor 2021) të ndarë sipas formës (shoqatë, fondacion, qendër) – nuk ekzistojnë forma ligjore të tilla.</p> <p>Numri i përgjithshëm i organizatave jofitimprurëse të shpërbëra dhe në proces likuidimi në administratën tatimore për vitin 2021 (nga 1 janar 2021 deri në dhjetor 2021) – nuk ekzistojnë statuse të tilla. Nëse ju intereson OJF në statusin ‘Të çregjistruar’ dhe ‘Kërkesa për çregjistrim’ që janë statuset e njohura nga legjislacioni tatimor, janë 10.</p>	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

		likuidimi në administratën tatimore për vitin 2021.				
20	07.03.2022	Informacion sesi mund të pajiset me Certifikatë Rezidence një subjekt që është degë e një shoqërie të huaj.	09.03.2021	<p>Procedura që duhet ndjekur për të aplikuar në DPT:</p> <p>Kërkesë me shkrim në të cilën të përcaktohet shteti dhe viti fiskal për të cilën aplikojnë, si dhe informacion të plotë në lidhje me arsyet e kërkesës për pajisje me Çertifikatë Rezidence Tatimore.</p> <p>Vërtetim origjinal lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit në të cilin jepen hyrjedaljet në Republikën e Shqipërisë, si dhe vërtetim në lidhje me adresën e banimit, si dhe kopje të dokumentit/dokumentave identifikues të përdorur nga individi aplikues. Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat personale të përfituara dhe deklaruar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Kontrata e pronësisë së bashku me një kopje të çertifikatës së pasurisë së paluajtshme, të banesës ku banon apo kontrata e qerasë sipas rastit, ku referuar kësaj të fundit dhe pagesën e tatimit mbi qeranë të mbajtur në burim.</p> <p>Kopje të dokumentit të identifikimit, passaportë ose kartë identiteti, brenda afateve ligjore përsa i takon vlefshmërisë.</p>	E plotë	Nuk ka
21	08.03.2022	Informacion mbi hapat që duhet të ndjekë për të marrë një vërtetim mbi kontributet dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore për individin	10.03.2022	<p>-Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;</p> <p>-Zgjidhni shërbimin ‘Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012);</p>	E plotë	Nuk ka

		nga viti 2012 e deri në dhjetor 2021.		-Klikoni butonin 'Përdor' për të parë dhe shkarkuar vërtetimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore si i punësuar me vulë elektronike. Vërtetimin e gjeneruar me vulë elektrike mund ta gjeni në çdo kohë në seksionin 'Dokumentet e mia' te hapësira juaj në portalin e –Albania.		
22	15.03.2022	Të ardhurat nga akciza, TVSH-ja, taksa e qarkullimit të ndara sipas kategorive përgjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2021. Të ardhurat nga akciza, TVSH-ja, taksa e qarkullimit të ndara sipas kategorive përgjatë periudhës 1 janar – 14 mars 2022. Të ardhurat nga akciza, TVSH-ja, taksa e qarkullimit gjatë periudhës 2016-2021.	16.03.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
23	15.03.2022	Informacion sesi mund të procedojë për pajisjen me dëshmi të ardhurash.	23.03.2022	Për të vërtetuar të ardhurat e përfituara në Shqipëri, që burojnë sipas përcaktimeve në nenin 4 'Burim i të Ardhurave' si dhe në nenin 8 'Të ardhurat e tatueshme', të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998, i ndryshuar, duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë Rajonale Tatimore të juridiksionit ku ka patur rezidencën ose qendrën e banimit.	E plotë	Nuk ka

				Individi i drejtohet institucionit tatimor, sa më sipër nëpërmjet një kërkesë nga ana e tij, ku kërkon pajisjen me vërtetim për të ardhurat e realizuara në periudhat tatimore që ai është i interesuar, si dhe tatimin mbi të ardhurat personale të paguar për të ardhurat, objekt i kërkesës. Depozitimi i kërkesës bëhet me prezencë fizike, pranë sporteleve të institucionit tatimor dhe /ose me rrugë postare.		
24	16.03.2022	Informacion mbi hapat që duhet të ndjek, mbi deklarin e të ardhurave nga shitja e një automjeti.	30.03.2022	Të gjithë individët tatimpagues, të cilët kanë përfituar të ardhura nga shitja e një automjeti (autoveturë), e përdorimit personal, nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale. Për ligjvënës, të ardhurat që burojnë nga shitja e një makine e përdorimit personal (autoveturë), blerë nga individët me mjete monetare të tatuara më parë në RSH, nuk janë të tatueshme përsëri në rastin e shitjes (kthimit të investimit nëpërmjet shitjes), pasi i referohet rasteve ku individi/ët kanë për qëllim zvëndësimin e automjetit me një të ri dhe jo me fitim kapital.	E plotë	Nuk ka
25	16.03.2022	Informacion mbi pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.	23.03.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
26	24.03.2022	Informacion për detyrimet tatimore duke përfshirë llojin e tatimit, penaltet përkatëse për subjektin X.	28.03.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës.	E plotë	Nuk ka
27	25.03.2022	Më datë 25.02.2022 kam bërë një kërkesë te Drejtoria	28.03.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12	E deleguar	Nuk ka

		e Sigurimeve Shoqërore, shpërblim për leje lindje për personat e punësuar. Kërkesa është shqyrtuar dhe është pranuar. Dua të di përse nuk më ka kaluar akoma pagesa në llogarinë time.		ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”		
28	29.03.2022	Problematikat që ka hasur institucioni juaj në lidhje me subjektet e karburanteve në tre vitet e fundit dhe penalitetet përkatëse.	11.04.2022	Të gjitha subjektet në fushën e hidrokarbureve kanë detyrim instalimin e pajisjes fiskale/sistemin e fiskalizimit menjëherë që fillojnë të ushtrojnë aktivitet. Në çdo rast që konstatohet një subjekt i fushës së hidrokarbureve me/pa pajisje fiskale që nuk zbaton rregullin e detyrueshëm “Pa kupon nuk ka karburant”, grupi i punës merr masën e bllokimit të dispenserit duke mos lejuar shitje dhe subjekti më pas kalon për ndjekje të mëtejshme nga instanca të tjera. Pra, mungesa e pajisjes fiskale/Sistemi fiskalizimit në çdo rast shoqërohet me bllokim shitjesh deri në instalimin e sistemit të monitorim qarkullimit. Rasti i tregtimit të hidrokarbureve ka të tjera specifika krahasuar me aktivitetet e tjera, kjo gjë e sqaruar dhe në VKM nr. 781 datë 14.11.2007.	E plotë	Nuk ka
29	29.03.2022	A janë kryer kontrolle tatimore gjatë viteve 2020 – 2021 në laboratorët X? A është ndonjë nga subjektet debitor në tatime?	31.03.2022	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve administron regjistrin e tatimpaguesve duke i identifikuar ata nëpërmjet NIPT-it (numri i identifikimit të personit të tatueshëm). Në sistemin tatimor nuk ka identifikim nëpërmjet	E plotë	Nuk ka

				licensave, për më tepër që një tatimpagues mund të ketë më shumë se një të tillë (nr. license) për aktivitete të ndryshme.		
30	31.03.2022	Informacion në lidhje me subjektin X. Informacion nëse subjekti ka bërë deklarime të pasqyrave financiare gjatë 6 viteve të fundit.	05.04.2022	Subjekti X është në status pasiv. Për periudhën e qëndrimit në regjistrin pasiv, tatimpaguesi nuk paraqet deklarata periodike tatimore.	E plotë	Nuk ka
31	06.04.2022	Cila është procedura që duhet të ndiqet nga një shtetas i huaj (grek) i cili ka një ‘person fizik’ të krijuar dhe regjistruar në Shqipëri, për shmangien e taksimit të dyfishtë sipas Konventës ‘Për Shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Kopje të dokumentacionit/formularit për deklarimin e të ardhurave që duhet të paraqiten në shtetin grek për shmangien e taksimit të dyfishtë.	12.04.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës, në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen për shmangien e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin.	E plotë	Nuk ka
32	08.04.2022	Pasqyrat Financiare për subjektet X.	12.04.2022	Në lidhje me Pasqyrat Financiare, këto akte përmbajnë të dhëna financiare dhe tregtare të tatimpaguesve, të cilat janë konfidenciale dhe administrata tatimore referuar ligjit nr.9920,	Refuzuar	Nuk ka

				‘Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit.		
33	15.04.2022	Xhiron Vjetore për subjektet X.	19.04.2022	Informacioni i kërkuar përmban të dhëna financiare dhe tregtare të tatimpaguesve, të cilat janë konfidenciale dhe administrata tatimore bazuar në ligjin nr.9920, ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit.	Refuzuar	Nuk ka
34	15.04.2022	Sa është shuma e remitancave e dërguar për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022.	19.04.2022	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon informacion në lidhje me të ardhurat nga remitancat, pasi nuk deklarohen në Administratën Tatimore.	E plotë	Nuk ka
35	15.04.2022	Informacion për çregjistrimin e subjektit X.	26.04.2022	Subjekti X figuron i çregjistruar në sistemin tatimor. Pranë informacionit tek Drejtoria e Shërbimit tek 21-Dhjetori është gati edhe vërtetimi që nuk figuron i regjistruar.	E plotë	Nuk ka
36	19.04.2022	Në fund të qershorit përfundon afati për faljen e penaliteteve të fiskalizimit për bizneset e vogla. A po mendohet për një tjetër shtyrje të faljes së gjobave? Fiskalizimi ka lënë jashtë tregjet e fruta perimeve dhe tregun e plehrave kimike, etj. A ka një plan për t’a zgjeruar	05.05.2022	Afatet e fillimit të efekteve të ligjit të fiskalizimit sipas fashave janë afate ligjore, të cilat nuk mund të shtyhen apo pezullohen me vullnetin e instancave ligjzbatuese siç është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Është në tagrin dhe kompetencë e instancave kompetente politikbërëse dhe ligjibërëse që në vijim të një analize të hollësishme të situatës duke marrë në konsideratë edhe të gjitha sugjerimet apo propozimet e grupeve të interesit apo institucioneve zbatuese të	E plotë	Nuk ka

		gamën e bizneseve që mund të fiskalizohen në vijim?		propozojnë dhe të vendosin lidhur me afatet ligjore. Ligji ka përcaktuar kategoritë e tatimpaguesve që nuk kanë detyrim për të lëshuar fatura të fiskalizuara. Në fiskalizim janë përfshirë të gjithë tatimpaguesit që tregtojnë fruta-perime dhe plehra kimike, përveç rasteve nëse ata janë ambulantë dhe përjashtohen nga ligji përkatës.		
37	19.04.2022	<p>Sa biznese janë fiskalizuar plotësisht nga fillimi i procesit e deri tani?</p> <p>Sa biznese kanë marrë certifikatën elektronike nga AKSHI dhe sa aplikime janë në proces?</p> <p>Cilat janë problemet që po hasin më shumë bizneset në zbatimin e fiskalizimit?</p> <p>Sa është kostoja mesatare e fiskalizimit për një biznes sipas Tatimeve?</p>	05.05.2022	<p>Tatimpagues të fiskalizuar në total janë 82.702.</p> <p>Janë pajisuar me certifikatë elektronike nga AKSHI 105.555 dhe kanë aplikuar për certifikatë 386.</p> <p>Problemet më të shumta që po hasin tatimpaguesit kanë të bëjnë me përshtatjen me mënyrën e re të faturimit dhe tipologjitë e ndryshme të faturimit sipas llojeve të ndryshme të bizneseve, dhe disa problematika që kanë të bëjnë me përshtatjen e sistemit të ri me atë të vjetrin si psh; mbyllja e faturave paradhënie, autofaturimi dhe shitjet me norma të ndryshme TVSH-je etj. Këto problematika po gjejnë zgjidhje rast pas rasti në bashkëpunim edhe me shoqërinë e zgjidhjeve softwarike dhe gjithë palët e përfshira në proces.</p> <p>Zgjidhjet që mundësojnë këtë proces janë në varësi të madhësisë dhe llojit të biznesit, por ato variojnë nga minimalet deri tek ato më të shtrenjtat që përfshijnë edhe hartimin e bilanceve.</p>	E plotë	Nuk ka

38	04.05.2022	Sa kanë qenë në numër Rivleresimet e Pasurive gjatë Janar-30 Prill / 2022? Nga këto, nëse e keni si informacion, sa kanë qenë për Apartamente, sa për Njësi Tregtare, sa për Industriale dhe sa për Toka? Sa kanë qenë të ardhurat në volume për sa për sipër, Janar-30 Prill 2022? A mund t'i kategorizojmë: Apartamente, Tregtare, Industriale, Toka?	04.05.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12 ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”	E deleguar	Nuk ka
39	04.05.2022	Çfarë ndryshimi ekziston midis këtyre dy kategorive të sigurimeve: I vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant deklarimi për vete nga i vetëpunësuar dhe i vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës), pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit, deklarimi nga personi fizik për vete.	04.05.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12 ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”	E deleguar	Nuk ka
40	04.05.2022	Informacion mbi VKM Nr.25 datë 13.04.2022 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të	04.05.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj, lutemi klikoni në linkun e mëposhtëm për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi dokumentat që duhet të plotësoni dhe dorëzoni pranë	E plotë	Nuk ka

		masës së kompesimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetas, rrethqytetase dhe ndërqytetase, pjesë e paketës antikrizë." Informacion për mënyrën sesi do të dorëzojmë dokumentacionin.		Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku jeni i regjistruar si subjekt. https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=12181		
41	05.05.2022	Në rast se një nga organizatat jofitimprurëse dëshiron të kryej restaurime në ndërtimet aktuale apo ndërtime të objekteve të reja, a përjashtohen nga TVSH për gjithë punimin, furnizimin dhe shërbimin që kompania e ndërtimit do të kryej bazuar në një kontratë sipërmarrje? Kush e bën kërkesën për përjashtim nga TVSH, kompania sipërmarrëse apo vetë organizata?	12.05.2022	Në rastin tuaj, nëse një institucion fetar merr shërbime ndërtimi nga një kompani ndërtimi e kontraktuar prej saj, atëherë shërbimi i ndërtimit ofruar për Bashkësinë Ungjillore VUSH (Kishë) është shërbim i tatueshëm me TVSH. Kategoritë e transaksioneve të përjashtuara nga TVSH pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së, janë furnizimet e përjashtuara që përfshihen në nenet 51, 52, 53, 54, 55, 56 të ligjit, të cilat, të cilat janë kategori: a) Përjashtim i veprimtarisë në interes të përgjithshëm sipas nenit 51 të ligjit. b) Përjashtime të tjera sipas nenit 53 të ligjit. c) Përjashtime në import sipas nenit 56 të ligjit. d) Të tjera përjashtime nga TVSH-ja sipas nenit 54 të ligjit. Thelbi i përjashtimit nga TVSH-ja konsiston në faktin se, aplikimi i përjashtimit nga TVSH-ja, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me natyrën e shërbimit ose të mallit	E plotë	Nuk ka

				(veprimtaria që kryen) dhe jo me entitetin ose subjektin që ofron shërbimin ose, mallin dhe as me personin që merr shërbimin ose mallin. Identiteti i palëve është i parëndësishëm.		
42	06.05.2022	Sa kompani që kanë marr leje ndërtimi janë gjobitur për fshehje të burimit të të ardhurave? Cilat janë emrat e kompanive të gjobitura?	16.05.2022	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk është institucioni kompetent për dhënie leje ndërtimi dhe mbi bazën e të dhënës (leje ndërtimi) nuk mund të identifikohet informacioni i kërkuar.	E plotë	Nuk ka
43	09.05.2022	Sa punonjës kanë ndjekur trajnime për zhvillimn e mëtejshëm të aftësive, njohurive etj? Sa shpenzoi vitin e shkuar institucioni juaj për trajnime, sa është fondi i planifikuar këtë vit? Keni bërë vlerësim për nevojat e mëtejshme për të rritur kapacitetet e stafit?	20.05.2022	Gjatë vitit 2021 janë trajnuar gjithsej 1370 punonjës të administratës tatimore qendrore, bazuar në kalendarin e trajnimeve sipas temave të miratuar, në bashkëpunim me QTATD/ASPA. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka një fond të parashikuar në buxhetin e institucionit dhe rrjedhimisht nuk ka shpenzime të parashikuara për trajnimin e punonjësve. Trajnimi i punonjësve të Administratës Tatimore bëhet pranë QTATD, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e cila ka një fond të drejtëpërdrejtë të parashikuar për trajnimin e punonjësve të sistemit tatimor dhe sistemit doganor, për tema të ndryshme sipas nevojës për trajnim të punonjësve. Gjithashtu punonjësit e Administratës Tatimore ndjekin trajnime pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA),	E plotë	Nuk ka

				<p>për tema të ndryshme që ajo ofron që lidhen me zhvillimin e tyre profesional.</p> <p>Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve në fund të vitit kalendarik identifikon nevojat për trajnim për punonjësit e Administratës Tatimore dhe Drejtori i Përgjithshëm miraton programin e trajnimit duke përcjellë nevojat për trajnim pranë QTATD dhe me vendim të Bordit të Akademisë Fiskale, pranë MFE, miratohet programi i trajnimit për vitin pasardhës.</p>		
44	13.05.2022	<p>Informacion lidhur me kopje të bilanceve të dorëzuara, llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për subjektet X, për periudhën 1 Janar 2019 -30 Prill 2022.</p>	17.05.2022	<p>Në nenin 25 ‘Konfidencialiteti’, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, ‘Për procedurat tatimore në RSH, nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës’.</p>	Refuzuar	Nuk ka
45	18.05.2022	<p>A është kryer rregullimi i deklarimit të pagave nga bizneset?</p> <p>A ka nisur kontrolli nga institucioni juaj?</p> <p>Sa është numri i bizneseve të cilat kanë rregulluar pagat e deklaruarat? Sa prej tyre nuk e kanë kryer ende këtë proces?</p> <p>Sa është numri i bizneseve të cilat u është drejtuar letër për vetërregullim të pagave të</p>	31.05.2022	<p>Po, një pjesë e bizneseve kanë reaguar pozitivisht ndaj nismës së antiinformalitetit Dhjetor 2021 duke rregulluar deklarimin e pagave deri më sot. Ka patur rritje të deklarimit të pagës për kategori profesionale të caktuara nga tatimpagues të vlerësuar me risk për të cilët janë dërguar letra të personalizuar për deklarimin real të pagës për punëmarrësit e tyre.</p> <p>Po, në vazhdim të nismës si fillim janë përzgjedhur disa tatimpagues dhe individë me risk nga Njësia Antiinformalitet për t’u</p>	E plotë	Nuk ka

		deklaruar përpam datës 20 Janar 2022?		kontrolluar në bazë të kritereve të riskut të përcaktuara nga po njësia. Nga matja e reagimit të tatimpaguesve të cilësuar me risk për të cilët është dërguar letër e personalizuar për deklarin real të pagës, 58% e tatimpaguesve kanë reaguar me rritje të pagave. Nga analiza e listëpagesës Shtator 2021 u identifikuan 10.153 tatimpagues me risk për të cilët u dërguan letra të personalizuar për deklarin real të pagave të punëmarrësve të tyre.		
46	23.05.2022	Kopje të njësuara me origjinalin, të çdo dokumenti që ndodhet në dosjen time. Të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për nxjerrjen e ‘Numrit Personal Identifikues’. Të gjithë të dhënat ligjore të disponueshme, për mënyrën e nxjerrjes së ‘Numrit Personal Identifikues’ në formatin letër.	26.05.2022	Administrata Tatimore nuk e disponon informacionin e kërkuar, nga ana juaj, që lidhen me, kopje të njësuara me origjinalin, të çdo dokumenti që ndodhet në dosjen time, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për nxjerrjen e ‘Numrit Personal Identifikues’, të gjithë të dhënat ligjore të disponueshme, për mënyrën e nxjerrjes së ‘Numrit Personal Identifikues’ në formatin letër. Lutemi për të marrë informacionin e kërkuar t’i drejtoheni autoriteteve përkatëse.	E plotë	Nuk ka
47	30.05.2022	Informacion mbi procedurën për përjashtimin Tatimi mbi Vlerën e shtuar si nënkontraktorë i një subjekti që do të ofrojë mall/shërbime një subjekti të autorizuar për qëllime të procesit të rindërtimit.	01.06.2022	Referuar shpjegimit të bërë në e-mail tuaj, rezulton se ju kryeni furnizime për subjektin “KOMPANIA B” shpk. Ky subjekt është pajisur me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm si furnizues/ nënkontraktor i shoqërisë “KOMPANIA A” shpk . Referuar sa më sipër, bëjmë me dije se, subjektet që kryejnë furnizime për furnizuesit	E plotë	Nuk ka

				e përcaktuar në shkronjën d) të nenit 3, të VKM-së së sipërcituar, nuk përfshihen te subjektet për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të lëshojë autorizim për përjashtim nga TVSH-ja. Pra, nëse ju kryeni furnizime për subjektin “KOMPANIA B” shpk, nuk përfshihen te subjektet që mund të pajiseni me autorizim.		
48	15.06.2022	Informacion lidhur me procedurën e autorizimit për përjashtimin nga skema e TVSH: Kur unë lidh një kontratë me një subjekt ndërtues a mund të aplikojë për autorizim dhe dokumentacioni që nevojitet. A mund të kem në dispozicion listën e subjekteve që kanë një autorizim të tillë.	16.05.2022	<p>Për të përfutur përjashtimin nga TVSH-ja, subjektet e rindërtimit duhet të jenë të autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t'u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, ndër të tjera duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve <u>marrëveshjen kuadër</u>, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës ose <u>marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit</u>, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit, ose <u>kontratën me ndërtuesin e autorizuar</u>.</p> <p>Përsa më sipër, bëjmë me dije se, nëse subjekti që bën kërkesën nuk ka një <u>marrëveshje kuadër, ose marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, ose kontratë me ndërtuesin e autorizuar</u>, nuk plotëson kushtet</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>për t'u pajisur me autorizim për përjashtimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar.</p> <p>Listën e subjekteve të autorizuara, lutemi e gjeni të publikuar në faqen Web të DPT-së, në linkun e mëposhtëm:</p> <p>https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1711/processi-i-rindrtimit-lista-e-subjekteve-t-pajisura-me-autorizim-per-perjashtim-nga-tvsh-ja</p>		
49	15.06.2022	<p>Sa është vlerësuar ekonomia informale çdo vit në 5 vitet e fundit?</p> <p>Sa është vlerësuar evazioni fiskal çdo vit në 5 vitet e fundit në tërësi dhe sipas sektorëve?</p>	28.06.2022	Administrata Tatimore në përmbushje të detyrimeve të saj funksionale mat dhe disponon të dhëna që kanë lidhje me indikatorët e përmbushjes së tatimpaguesve dhe nuk bën vlerësime makro mbi ekonominë.	E plotë	Nuk ka
50	21.06.2022	Informacion mbi listën me subjektet aktive që ushtrojnë veprimtari ekonomike në kategorinë 'Hotel'.	22.06.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës, në lidhje me listën e subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike në kategorinë 'Hotel'.	E plotë	Nuk ka
51	21.06.2022	<p>Sa call center operojnë aktualisht në Shqipëri?</p> <p>Sa është numri i të punësuarëve në këto biznese?</p> <p>Sa vlerësohet vlera totale që këto biznese sjellin për ekonominë shqiptare?</p>	01.07.2022	<p>Numri total i subjekteve call-center është 2,763.</p> <p>Numri i të punësuarëve total për subjektet call-center për periudhën e fundit tatimore Maj 2022, nga listëpagesa është 12,018.</p> <p>Vlera e paguar në lekë për vitin 2021 nga subjektet call-center është 4,144,332,855.</p>	E plotë	Nuk ka

		Sa vlerësohet rritja vjetore e këtij sektori?		Për vitin 2021 rritja vjetore rezulton 5,17% krahasuar me të ardhurat e deklaruar në vitin 2020.		
52	23.06.2022	Informacion mbi letrën e dërguar nga DPT për Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA).	24.06.2022	Referuar të dhënave në sistemin tatimor për vitin 2021 rezultoni e punësuar në dy punëdhënës të ndryshëm. Periudha për të cilën rezultoni e dypunësuar është 2103 (Mars 2021). Ju bëjmë me dije se, në rastin kur një individ ka ndryshuar punëdhënësin e tij dhe është punësuar në një punëdhënës tjetër, brenda të njëjtit muaj (duke filluar nga janar 2020), me një total pagash mujore bruto mbi 30.000 lekë, atëherë ai duhet të deklarojë Deklarata Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA), pasi ka detyrimin për të paguar Tatimin mbi të Ardhurat nga Punësimi, sipas përcaktimit të Ligjit nr.8438 ‘Për tatimin mbi të Ardhurat’, i ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
53	30.06.2022	Numri total i subjekteve OJF-ve që ndodhen në statusin pasiv.	01.07.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës në lidhje me numrin e subjekteve OJF-ve që ndodhen në statusin pasiv.	E plotë	Nuk ka
54	01.07.2022	Pasqyrat e plota financiare, transaksionet, donacionet, shpenzimet dhe bilancet e plota ndër vite për OJF ‘X’.	12.07.2022	Të dhënat e kërkuara prej jush përbëjnë të dhëna të detajuara, konfidenciale dhe sensitive për tatimpaguesit. Administrata Tatimore ka detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tatimpaguesve, me përjashtim të rasteve kur merret pëlqimi nga ana e tyre.	Refuzuar	Nuk ka
55	07.07.2022	Jam vetë administratore pa punëtoje. Duke patur dhe	14.07.2022	Theksojmë se, nuk janë deklarues të Deklaratës Individuale Vjetore të të	E plotë	Nuk ka

		biznesin tim edhe duke punuar diku tjetër, pra duke paguar dy here sigurime, a kam ndonjë taksë ose tatim që shtohet për këtë periudhë?		Ardhurave (DIVA) <u>kategoria “I vetëpunësuar”</u> (me të gjitha kategoritë e të vetëpunësuarit) dhe i punësuar në një subjekt (person fizik apo juridik) në të cilin përfiton të ardhura nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punës, pasi kategoria “I vetëpunësuar” ka detyrim vetëm për pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe ka të përcaktuar në listëpagesë vlerën zero në rubrikën “Paga bruto”.		
56	07.07.2022	Informacion lidhur me periudhën e punësimit të Znj. 'X', duke filluar nga viti 2017 e në vijim.	27.07.2022	Iu bëjmë me dije se informacionin për periudhat e punësimit dhe derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, çdo individ mund t'a aksesoj (personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar) edhe nga portali e-albania, tek shërbimet: "Deklarimi dhe pagimi i kontributeve nga punëdhënësit" dhe "Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012).	E plotë	Nuk ka
57	11.07.2022	Informacion mbi çmimet e shitjes së karburanteve dhe tabelat informuese për subjektin 'X'.	21.07.2022	Subjekti 'X' rezulton i regjistruar në QKB dhe organin tatimor. Ka të implementuar procesin e Fiskalizimit dhe lëshon faturë të Fiskalizuar. Subjekti ka të vendosur tabela ku pasqyrohet në mënyrë të dukshme lloji dhe çmimi i produktit.	E plotë	Nuk ka
58	09.08.2022	Sa biznese (estetikë, parukeri etj) janë të regjistruara në Tiranë dhe në vend? Sa prej tyre janë regjistruar për dy vitet e fundit 2020-	15.08.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka

		2021 dhe 6 mujorin e fundit të vitit 2022?				
59	10.08.2022	Sa është numri total i personave të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2021? Sa është numri i të rinjve (18-29) vjeç të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2021?	15.08.2022	Numri total i personave të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 është 87.176. Numri i të rinjve (18-29) vjeç të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 është 8.443.	E plotë	Nuk ka
60	10.08.2022	Informacion mbi praktikën ligjore të emërimit të z. 'X'.	17.08.2022	Përsa kërkohet në kërkesën tuaj, iu bëjmë me dije se, referuar Vendimit nr. 833, datë 28.10.2022 për rregullat e hollësishme për mirëmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit, kreu II, pika 2: Dosja e personelit ka karakter konfidencial.	E plotë	Nuk ka
61	15.08.2022	Informacion se në emër të kujt është regjistruar biznesi që figuron me numër 'X' në regjistrin tatimor? A është ky biznes në emër të z.'X'.	26.08.2022	Administrata Tatimore identifikon subjektet me anë të NIPT (numër identifikimi i personit të tatueshëm), i cili është unik dhe i papërsëritshëm. Kërkimi mbi bazën e të dhënave të dërguara nga ana juaj (emër/mbiemër), nuk është i saktë pasi në sistem figurojnë disa persona me të njëjtat gjeneralitete.	E plotë	Nuk ka
62	15.08.2022	Informacion nëse ka qenë subjekt tatim-pagues z. 'X' dhe a i ka paguar detyrimet tatimore?	26.08.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj, iu bëjmë me dije se z. 'X' ka qenë i regjistruar për ushtrim aktiviteti dhe ka paguar detyrime tatimore sipas përgjegjësisve përkatëse.	E plotë	Nuk ka
63	30.08.2022	Informacion për subjektet 'X' në lidhje me lëshimin e faturës tatimore.	13.09.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka

64	07.09.2022	Informacion lidhur me shfuqëzim aktesh administrative dhe fshirje detyrimesh tatimore.	09.09.2022	Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si dhe pika 2, neni 12 ligjit “Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarës. Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.”	E deleguar	Nuk ka
65	12.09.2022	Informacion mbi efektet monetare dhe fiskale që ka sjellë ndryshimi i skemës së TAP-it në Shqipëri.	23.09.2022	Administrata Tatimore është një institucion ekzekutues dhe zbatues i legjislacionit në fuqi. Nuk ka iniciativë ligjvënëse dhe nuk harton politika fiskale.	E plotë	Nuk ka
66	13.09.2022	Sa është numri i punëmarrësve të cilët kanë përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të zgjidhjes së kontratës për periudhën 2017-2022? Sa prej tyre i janë drejtuar gjykatës? A ka patur raste ku punëmarrësve iu është ofruar zgjidhja e konfliktit nëpërmjet ndërmjetësimit?	26.09.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
67	14.09.2022	Informacion lidhur me sistemin e ri të faturimit për llogari të tatimeve.	27.09.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
68	15.09.2022	Informacion mbi procedurën që duhet ndjekur për të	15.09.2022	Kërkesë me shkrim në të cilën të përcaktohet shteti dhe viti fiskal për të cilën aplikojnë, si	E plotë	Nuk ka

		aplikuar në DPT për t'u pajisur me çertifikatë rezidente tatimore.		dhe informacion të plotë në lidhje me arsyet e kërkesës për pajisje me Çertifikatë Residence Tatimore. Vërtetim origjinal lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit në të cilin jepen hyrjedaljet në Republikën e Shqipërisë, si dhe vërtetim në lidhje me adresën e banimit, si dhe kopje të dokumentit/dokumentave identifikues të përdorur nga individit aplikues. Dokumentat që vërtetojnë të ardhurat personale të përfituara dhe deklaruar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Kontrata e pronësisë së bashku me një kopje të çertifikatës së pasurisë së paluajtshme, të banesës ku banon apo kontrata e qerasë sipas rastit, ku referuar kësaj të fundit dhe pagesën e tatimit mbi qeranë të mbajtur në burim. Kopje të dokumentit të identifikimit, passaportë ose kartë identiteti, brenda afateve ligjore përsa i takon vlefshmërisë.		
69	15.09.2022	Organizatat Jofitëprurëse të regjistruara në statusin aktiv.	27.09.2022	Numri i Organizatave Jofitëprurëse me status aktiv është 2271.	E plotë	Nuk ka
70	28.09.2022	Informacion në lidhje me pagesën totale të rentës minerare për subjektet 'X'.	11.10.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarës DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
71	04.10.2022	Informacion mbi procedurën që duhet të ndjek për t'u regjistruar për taksën e tatimit mbi burim?	06.10.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka

72	06.10.2022	Informacion në lidhje me praktikat e studentëve pranë bizneseve të ndryshme.				
73	10.10.2022	Informacion për numrin e shërbimeve online dhe cilat janë ato?	10.10.2022	Lutem në link-un e mëposhtëm gjeni informacionin në lidhje me shërbimet online që ofrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. https://192.168.221.89/c/545/584/sherbimet-qe-ofrohen-nga-dpt	E plotë	Nuk ka
74	19.10.2022	Sa i përket regjistrimit të pronarit përfitues për herë të parë për një OJF, a është pronar përfitues Presidenti kur votat në bord janë të barabarta, ai ka një votë me tepër pasi OJF nuk ka fitime as kuotë. Afati 40 ditor për regjistrimin e pronarit përfitues të një shoqate, nis nga dita që del vendimi i gjykatës që ka miratuar shoqatën apo ditën që shoqata merr NIPT, pra regjistrohet në tatime. Me dokument pronësie ose qeraje mbi vend-ndodhjen e selisë, nëse nuk zotërohet pronësia, kuptohet një kontratë qeraje apo mund të kuptojë dhe kontratë	01.11.2022	Përsa i takon pyetjes, se nëse Presidenti konsiderohet pronar përfitues, sqarojmë se, pronësinë ndaj pasurive të OJF e kanë të gjithë themeluesit e organizatës të përcaktuar me Vendimin e Gjykatës, në momentin e krijimit të saj, kështu që të drejtën për regjistrim në bazë të Ligjit Nr.112/2020 e kanë të gjithë themeluesit e OJF. Pra, afati për regjistrim brenda 40 (dyzet) ditëve kalendarike do të llogaritet duke filluar nga data e krijimit të OJF me Vendim Gjykatë. Pavarësisht faktit se qiradhënësi nuk posedon certifikatën e pronësisë, por posedon të drejtën reale mbi pronën, qeramarrësi, duhet të lidhë një kontratë "huapërdorje" dhe/ose "kontratë qeraje" me qeramarrësin, ku ky i fundit ka të drejtën ligjore të mbajë, llogarisë, deklaroj dhe paguaj tatimin në burim, për ambientin që përdorë, si zyrë dhe/ose seli të vetë.	E plotë	Nuk ka

		huapërdorje për një ambient të vogël pune, një tavolinë etj.				
75	28.10.2022	Akses në bazën ligjore për tatimin e të dypunësuarëve (DIVA). Si përcaktohet ‘punë e parë – punë e dytë’, në tatimin e të ardhurave të të dypunësuarëve që paguhen në total + 200000 lekë në muaj?	03.11.2022	Baza ligjore lidhur me tatimin mbi të ardhurat nga dypunësimi është: a) Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar nenet 13 deri 13/10. Përsa i përket të ardhurave nga punësimi në më shumë se një punëdhënës, nuk ka lidhje me punë e parë - punë e dytë. Referuar dispozitave të nenit 10 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar secili punëdhënës llogarit, mban dhe paguan në llogari të administratës tatimore tatimin mbi të ardhurat personale nga paga, referuar shkallës tatimore të përcaktuar në tabelën nr.1 bashkëlidhur ligjit. Në këtë rast, secili punëdhënës ka zbatuar 0% tatim për një pjesë të pagës të përcaktuar në tabelë.	E plotë	Nuk ka
76	15.11.2022	Jam PF dhe kërkoj verifikimin dhe konfirmimin e listëpagesave për periudhat janar 2006, mars 2006, shtator 2009, janar 2011 dhe qershor-dhjetor 2011.	24.11.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
77	18.11.2022	Më ka dalë NIPT-i dhe dua të logohem në faqen e tatimeve. Informacion ku	18.11.2022	Çdo tatimpagues i ri, pasi është regjistruar dhe pajisur me NIPT, hyn në sistem nëpërmjet fjalëkalimit Tatimetemia12	E plotë	Nuk ka

		mund t'a marr passwordin për t'u loguar.		Në vijim, bëhet menjëherë ndryshimi i fjalëkalimit në menunë, 'Ndrysho Fjalëkalimin'. Duke klikuar mbi të tatimpaguesi duhet të ndryshojë fjalëkalimin. Ky ndryshim është i detyrueshëm. Në rast të kundërt tatimpaguesi nuk mund të vijoje me deklarin.		
78	21.11.2022	Problematikë në lidhje me shërbimin vërtetimin për pagimin e kontributeve për individin.	22.11.2022	Marrë në konsideratë që të dhënat e vërtetimit sipas logjikës së implementuar i përkasin një intervali të barabartë me vitin aktual dhe vitin e plotë paraardhës, përsa kohë nuk identifikohet asnjë datë punësimi dhe deklarimi për këtë punonjës në intervalin e periudhave janar 2021-shtator 2022, shërbimi kthen përgjigjen që nuk u gjet asnjë e dhënë. Si alternativë shërbimi që mund të përdoret është Deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit.	E plotë	Nuk ka
79	24.11.2022	A keni kryer kontrolle në subjektet tregtare për shitjen e cigareve elektronike tek personat nën moshën 18 vjeç? Sa raste të tilla keni konstatuar konkretisht? Çfarë masash keni marrë ndaj subjekteve tregtare?	09.12.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
80	30.11.2022	Jam PF, kërkoj informacion në lidhje me vlerësimin tatimor për emetimin e	30.11.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka

		urdhërpagesave në llogarinë time si tatimpagues.				
81	30.11.2022	Informacion mbi masat administrative në total për 5 vitet e fundit ndaj subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve.	13.12.2022	Në lidhje me kërkesën e të interesuarit DPT vë në dispozicion informacionin sipas kërkesës së ardhur.	E plotë	Nuk ka
82	20.12.2022	Sa Call Center tatimpagues ka në RSH? Sa është numri i të punësuarëve në total për periudhën e fundit tatimore?	22.12.2022	Numri i të punësuarëve total për periudhën e fundit tatimore të mbylluar (09.2022) është 719.696. Aktivitete të qendrave telefonike (call center) janë 539.	E plotë	Nuk ka

Shënim: (1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

(2) Data e regjistrimit të kërkesës.

(3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(4) Data e kthimit të përgjigjes.

(5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

(7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik